



Jeanis Pleuro
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

KUVENDI
NR. 413 DATE 02.01.24

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ___/___/2024

Lënda: Për propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021 "Për gardën e Republikës së Shqipërisë"

Drejtuar: Zj. Lindita Nikolla
Kryetar i Kuvendit

Ë nderuar zj. Nikolla,

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, në cilësinë e deputetit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021 "Për gardën e Republikës së Shqipërisë", sipas tekstit dhe relacionit bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,

DEPUTETI
Nasip Mito

[Signature]

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33/2021, “PËR
GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me miratimin e ligjit të ri për Gardën e Republikës, përkatësisht ligjit 33/2021, Kuvendi siguroi një reformim tërësor të këtij institucioni, duke garantuar që Garda e Republikës t'i përgjigjet sfidave të sigurisë dhe të sigurojë mbrojtje më të lartë e më të specializuar për personalitetet e larta shtetërore të vendit dhe ato homologe të shteteve të tjera, gjatë qëndrimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. Ligji i ri i Gardës së Republikës e ka arritur qëllimin e tij parësor, duke siguruar një riorganizim tërësor të Gardës së Republikës si dhe duke krijuar kushtet e nevojshme për përmbushjen e misionit të saj, në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat standarte, si edhe shërbimet e ngjashme në Evropë.

Sidoqoftë, si pjesë e vlerësimit që kam kryer, si deputet por edhe njëkohësisht si Kryetar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, gjatë raportimeve por edhe gjatë konsultave, kam konstatuar që ligji 33/2021 ka disa çështje që duhet të rregullohen, me qëllim sigurimin e funksionimit të plotë të Gardës së Republikës. Në këtë drejtim, siç edhe do të shpjegohen më poshtë, është e nevojshme të rregullohet kohëzgjatja e ruajtjes së personaliteteve të tjera dhe banesave të tyre, pas përfundimit të mandatit, të përcaktohen kushtet dhe kriteret për për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës, me qëllim shëndrrimin e këtij procesi në një proces konkurrues e meritokratik, të rregullohet e drejta e kompensimit financiar, për trajtimin me veshmbathje civile si dhe, më e rëndësishmja, të njihet koha e qëndrimit në gradë, sipas ligjit të mëparshëm, duke siguruar kështu, vazhdimësinë e karrierës së punonjësve të Gardës së Republikës, pavarësisht ndryshimit të sistemit të gradave.

II. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTLIGJI

Në pikën 4, të nenit 13 dhe në pikën 3 të nenit 14, të ligjit 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, citimi “*Kohëzgjatja e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës nga ana e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave*”, nuk është i plotë dhe krijon hapësira për interpretime që e rrisin artificialisht numrin e personaliteteve që u takon ruajtje mbas lënies së detyrës.

Përdorimi i togfjalëshit “*personalitete të tjera*” në kuptim të këtij ligji dhe të VKM nr. 597, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, përfshin të gjithë ato personalitete që kanë mbrojtje apo shoqërim nga Garda gjatë ushtrimit të detyrës, çka praktikisht është e pamundur të realizohet pas lënies së detyrës, pasi do të kërkonte një shtesë të konsiderueshme në numrin e punonjësve, e rrjedhimisht kosto financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Në këtë drejtim, propozohet që kjo kategori personalitetesh, të mos ketë mbrojtje automatikisht pas lënies së detyrës, por të ketë mbrojtje vetëm në ato raste kur i rrezikohet jeta ose shëndeti, i tyre ose i familjes së tyre, për shkak të detyrës së mëparshme që kanë kryer. Në këtë mënyrë, sigurohet një përdorim më eficient i burimeve të Gardës si dhe uljet e kostos panevojshme për buxhetin e shtetit.

Nga ana tjetër, ligji aktual ka parashikuar disa kritere kufizuese në përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, dhe nuk parashikon një procedurë përzgjedhëse konkurruese. Drejtuesi i Gardës së Republikës, duhet të jetë një personalitet i rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri, dhe propozimi që Ministri i Brendshëm i bën Kryeministrit, duhet t’i jetë nënshtruar një procesi konkurrues, ndërmjet kandidatëve më të mirë që plotësojnë këto kritere, siç janë parashikuar në projektligj. Vetëm nëpërmjet kësaj mënyrë, sigurojmë një drejtues që ka vizionin dhe aftësitë për t’ju përgjigjur nevojave të sigurisë që Garda e Republikës duhet të përballojë në ruajtjen e personaliteteve të larta të vendit.

Po ashtu, pavarësisht se neni 59 i ligjit, ka përcaktuar që punonjës të strukturave të veçanta, të përcaktuara me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, trajtohen me veshje civile; nuk ka përcaktuar rregullat dhe procedurat që duhen zbatuar për gëzimin e kësaj të drejte, duke e shëndërruar këtë rregullim në të pazbatueshëm. Për këtë qëllim, propozohet shtimi i një dispozite

deleguese që i jep të drejtën Ministrit të Brendshëm që të rregullojë me urdhër rregullat dhe masën e kompensimit në vlerë monetare të kësaj të drejte.

Së fundmi, është vënë në dukje që prej hyrjes në fuqi të ligjit 33/2021, është bllokuar procesi i konkurrimit për gradë, pasi në nenin 37 përcaktohen afatet e qëndrimit në gradë, me emërtimet e reja dhe numërimi fillon nga viti 2021. Pavarësisht se ligji njësoi sistemin e gradave me gradat e mëparshme, nuk rregulloi kohën e qëndrimit në gradat e mëparshme, për efekt të kohës së qëndrimit në gradat e njësuara. Për këtë qëllim, propozohet që të njihet kjo kohë qëndrimi, dhe procesi i gradimit të ecë rregullisht, pavarësisht ndryshimit të sistemit dhe emërtimit të gradave.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i paraqitur është në përputhje me nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe është paraqitur në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Kuvendit.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 6 nene.

Në nenin e parë dhe të dytë, është përcaktuar rregulli që e drejta e mbrojtjes personale gëzohet edhe nga personalitetet e tjera, por kjo e drejtë është e kufizuar. Pra, në ndryshim me Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, që e gëzojnë të drejtën e mbrojtjes personale dhe të banesës, në mënyrë të pakufizuar, për maksimumi 5 dhe 4 vjet; në rastet e personaliteteve të tjera, kjo e drejtë është e kushtezuar, qoftë në kohëzgjatje, ashtu edhe në rastet se kur mund të përfitohet kjo e drejtë. Po ashtu, të dy dispozitat, i delegojnë të drejtën Këshillit të Ministrave, që me vendim, të përcaktojnë rregullat, procedurën dhe kohëzgjatjen e këtyre të drejtave.

Në nenin e 3, është vendosur detyrimi për të pasur një proces konkurimi të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe

mosdiskriminimi për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës. Nga ana tjetër, për shkak të karakterit teknik të ktyre rregullimeve, i delegohet e drejta Ministrit që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për Drejtor të Përgjithshëm të Gardës së Republikës.

Gjithashtu, me këtë nen, janë shtuar kriteret që duhet të përmbushë kandidati për drejtor të përgjithshëm, me qëllim që të përzgjidhet kandidati më i mirë dhe më i kualifikuar për ushtrimin e kësaj detyre të rëndësishme.

Në nenin 4 është rregulluar çështja e trajtimit me veshmbathje të punonjësve të gardës, për struktura të veçanta të saj. Përkatësisht, këto punonjës këtë të drejtë do të mund ta ushtrojnë nëpërmjet kompensimit në vlerë monetare. Sidoqoftë, me qëllim që vlera monetare t'i përgjigjet kushteve të tregut, i është deleguar e drejta ministrit të brendshëm për përcaktimin e kësaj mase.

Në nenin 5, njihet koha e qëndrimit në gradat e fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, "Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë", për efekt të ecurisë në gradë, si kohë e qëndrimit në gradën e njësuar, sipas këtij ligji, duke zgjidhur në këtë mënyrë një problem që prekte karrierën e çdo punonjësi të Gardës së Republikës.

Në nenin 6 është përcaktuar që ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33/2021, “PËR
GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.33/2021 “Për gardën e Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Neni 13, pika 4, ndryshohet si më poshtë:

“4. Personalitetet e tjera, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes personale pas përfundimit të detyrës, kur i rrezikohet jeta ose shëndeti për shkak të detyrës që kanë kryer. Rregullat, procedura dhe kohëzgjatja e mbrojtjes personale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 2

Neni 14, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

”4. Personalitetet e tjera gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe mbrojtjen e banesës pas përfundimit të detyrës kur i rrezikohet jeta ose shëndeti, i tyre ose i familjes së tyre, për shkak të detyrës që kanë kryer. Rregullat, procedura dhe kohëzgjatja e ruajtjes dhe mbrojtjes së banesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 3

Në nenin 17, bëhet shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: ”Ministri i propozon Kryeministrin kandidat për Drejtor të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, pas kryerjes së një procesi të konkurimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimi. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për Drejtor të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, përcaktohen me udhëzim të Ministrit”.

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

”2. Drejtor i Përgjithshëm i Gardës së Republikës mund të emërohet shtetasi shqiptar, që në kohën e kandidimit përmbush këto kushte:

- a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë në fushën e rendit ose sigurisë;
- dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e rendit ose sigurisë;
- e) të mos jetë larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;
- ë) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) të mos ketë marrë cilësinë e të pandehurit për kryerjen e një vepre penale, ose ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë e sigurimit personal;
- g) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.”

Neni 4

Në nenin 59, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

”4. E drejta e trajtimit me veshje civile, për punonjësit e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përfitohet nëpërmjet kompensimit në vlerë monetare, në masën, dhe sipas rregullave të përcaktuara me udhër të Ministrit”.

Neni 5

Në nenin 68, paragrafi i parë numërtohet me numrin “1” dhe pas paragrafit të parë, shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Koha e qëndrimit në gradat e fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, për efekt të ecurisë në gradë, konsiderohet si kohë e qëndrimit në gradën e njësuar, sipas këtij ligji”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA